

VENDIM

Nr. 268, datë 29.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 748, DATË 11.6.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT AKADEMIK NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*", dhe të ligjit nr.130/2016, "*Për buxhetin e vitit 2017*", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, "Struktura dhe nivelet e pagave sipas kategorive të vendeve të punës, për nëpunësit e institucioneve publike të arsimit të lartë", që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Në pikën 7, pagesa për çdo orë mësimore mbi normën e miratuar me dispozitë, e përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d", të kësaj pike, ndryshon, si më poshtë vijon:

"a) Kur janë në kategorinë "Profesor", përfitojnë 1 320 (një mijë e treqind e njëzet) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

b) Kur janë në kategorinë "Profesor i Asociuar", përfitojnë 1 210 (një mijë e dyqind e dhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

c) Kur janë në kategorinë "Docent", përfitojnë 1 100 (një mijë e njëqind) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

ç) Kur janë "Lektor i parë", përfitojnë 880 (tetëqind e tetëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe;

d) Kur janë "Lektor", përfitojnë 660 (gjashtë-qind e gjashtëdhjetë) lekë për çdo orë 60-minutëshe."

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2017, të përballohen nga fondet e politikës për rritjen e pagave, të përcaktuara në ligjin nr.130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT
AKADEMIK, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

Nr. rendor Pozicioni Paga

1. Rektor (titullar institucioni) 139800
2. Zëvendësrektor, nga kategoria "Profesor" 132200
3. Zëvendësrektor, nga kategoria "Docent"/"Doktor" 130500
4. Dekan nga kategoria "Profesor" 132200
5. Dekan nga kategoria "Docent"/"Doktor" 130500
6. Zëvendësdekan, nga kategoria "Profesor" 121000
7. Zëvendësdekan, nga kategoria "Docent"/"Doktor" 106700
8. Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Profesor" 123800
9. Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Docent"/"Doktor" 106700
10. Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Profesor" 123800
11. Titullar i grupit mësimor-kërkimor nga kategoria "Docent"/"Doktor" 106700
12. Profesor 121000
13. Profesor i asociuar 105200
14. Docent (Doktor) 95800
15. Docent (Master) 91800
16. Lektor i parë/Kërkues i parë 90300
17. Lektor/Kërkues 73400